REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:024598
Datë:	26.02.2024
Numri i dokumentit:	05372212

Ac.nr.9731/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi –Kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Besnik Bislimaj anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Biondina Zeneli, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës-propozueses Sh.G, E.G, dhe A.(J.)G, që të gjithë nga fshati....., Komuna e Malishevës të cilët me autorizim i përfaqësojnë avokatët S.B dhe G.E nga....., kundër Organit Shpronësues Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria Ekonomisë dhe Financave të cilën e përfaqëson N.A nga Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me kompensimin për paluajtshmëritë e shpronësuara dhe për humbjen e vlerës të pronës së mbetur nga shpronësimi, duke vendosur sipas ankesës së kundër-propozueses të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë, CN.nr.108/2019, i datës 06.10.2021, dhe aktvendimit korrigjues, CN.nr.108/2019, i datës 18.10.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e kundër-propozueses Organit Shpronësues Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria Ekonomisë dhe Financave, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë, CN.nr.108/2019, i datës 06.10.2021 **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar CN.nr.108/2019, i datës 06.10.2021, ka vendosur si në vijim:
"I.APROVOHET si e bazuar ankesa- propozimi i precizuar i propozuesve Sh.G, E.G, dhe A.(J.)G, që të gjithë nga fshati....., Komuna e Malishevës për nga baza juridike ndërsa pjesërisht Aprovohet për nga lartësia e kompensimit ashtu që CAKTOHET kompensimi për sipërfaqet e ngastrave të shpronësuar dhe humbjen e vlerës të sipërfaqeve të mbetura nga shpronësimi si në vijim;
a). për ngastrën .....-.... ZK ..... , sipërfaqen e shpronësuar prej 2366m2 caktohet vlera prej 39.00 euro për m2 , përkatësisht shuma e përgjithshme prej 91,592.95 euro, ndërsa për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim të kësaj ngastre prej 381m2 në vlerën e humbur prej 80% caktohet vlera prej 31.20euro m2 përkatësisht vlera e përgjithshme në shumë prej 11,869.17euro.

2021:265050

b).për ngastrën .....-.. ZK ...,sipërfaqen e shpronësuar prej 890 m2 caktohet vlera prej 39.55 për m2, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 34,943.32 euro, ndërsa për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim prej 3120m2 në vlerën e humbur prej 50% caktohet vlera prej 19.78 euro për m2 përkatësisht vlera e përgjithshme në shumë prej 61,565.92 euro.

c). për ngastrën .....-.. ZK ...,, sipërfaqen e shpronësuar prej 624 m2 caktohet vlera prej 37.89euro për m2, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 23,463.74 euro, ndërsa për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim prej 283m2 në vlerën e humbur prej 80% caktohet vlera prej 30.31euro për m2 përkatësisht vlera e përgjithshme në shumë prej 8,564.33 euro.

II.DETYROHET Organi Shpronësues - Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria Ekonomisë dhe Financave për sipërfaqet e ngastrave të shpronësuar me numër .....-..,.....-.. dhe ngastrës ....-.. dhe humbjen e vlerës të sipërfaqeve të mbetura nga shpronësimi të këtyre ngastrave sipas vendimit përfundimtar numër 09/151 të datës 11.10.2013, ankuesve - propozuesve ti kompensoj diferencën me shumat si në vijim, për:
a).Sh.G nga fshati..... Komuna e Malishevës, për ngastrën .....-.. ZK...., ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 44.272.95 euro, për sipërfaqen e shpronësuar prej 2366m2, sipas vlerës së caktuar prej 39.00 euro për m2, dhe shumë prej 11,869.17 euro për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim të kësaj ngastre prej 381m2 në vlerën e humbur prej 80%, sipas vlerës së caktuar prej 31.20euro për m2, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 7% nga data 11.10.2013 kur është nxjerrë vendimi përfundimtar për shpronësim e deri në pagesën definitive.

Ndërsa shuma prej 681.05 euro në emër të kompensimit të diferencës së vlerës për sipërfaqen e shpronësuar dhe shuma prej 18.03 euro në emër të vlerës së humbur të pronës së shpronësuar për tej shumës së gjykuar për ngastrën si në pikën (a) refuzohen si të pa bazuar.

b). Sh.G dhe A.G nga fshati..... Komuna e Malishevës si bashkëpronar me nga 1/2 për ngastrën .....-.. ZK....., ti kompensoj diferencën e vlerës secilit veç e veç shumën nga 8.571.66 euro, për sipërfaqen e shpronësuar prej 890 m2 sipas vlerës së caktuar prej 39.55 për m2 , dhe secilit veç e veç shumën nga 30.782.96euro për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim prej 3120m2 në vlerën e humbur prej 50% sipas vlerës së caktuar prej 19.78 euro për m2, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 7% nga data 11.10.2013 kur është nxjerrë vendimi përfundimtar për shpronësim e deri në pagesën definitive.

Ndërsa secilit shumat nga 128.09 euro në emër të kompensimit të diferencës së vlerës për sipërfaqen e shpronësuar dhe shumat nga 73.84 euro euro në emër të vlerës së humbur të pronës së shpronësuar për tej shumës së gjykuar për ngastrën si në pikën (b) refuzohen si të pa bazuar.

c). E.G nga fshati..... Komuna e Malishevës për ngastrën ....-.. ZK....., ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 23,643.36 euro, për sipërfaqen e shpronësuar prej 624 m2 sipas vlerës së caktuar prej 37.89euro për m2 , dhe shumën prej 8,578.30euro për sipërfaqen e mbetur nga shpronësim prej 283m2 në vlerën e humbur prej 80% sipas vlerës së caktuar prej 30.31euro për m2, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 7% nga data 11.10.2013 kur është nxjerrë vendimi përfundimtar për shpronësim e deri në pagesën definitive.

Ndërsa shuma 179.62 euro në emër të kompensimit të diferencës së vlerës për sipërfaqen e shpronësuar dhe shuma prej 13.40 euro në emër të vlerës së humbur të pronës së shpronësuar për tej shumës së gjykuar për ngastrën si në pikën (c) refuzohen si të pa bazuar.

III.OBLIGOHET Kundër propozuesi Organi Shpronësues, që në emër të pagesës për shpenzime procedurale, ankueseve t'ia paguaj shumën totale prej 7323 euro, të gjitha këto në afat prej 15

2021:265050

ditësh, pas plotfuqishmërisë së Aktvendimit dhe Obligohet që në emër të plotësimit raportit vlerësues të grupit të ekspertëve I.B, A.Ç dhe B.B datës 06.10.2020 ti paguaj shumën prej 100 euro ekspertit I.B , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij Aktvendim nën paralajmërimin e përmbarimit të detyrueshëm.

IV.Obligohen Ankuesit që bashkërisht në ata prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktvendimi të paguajnë shumën prej 391.99 euro në emër të taksë gjyqësore shtesë për lartësinë e kërkesës së ankesë së precizuar."

Ndërsa me aktvendimin korrigjues, CN.nr.108/2019, i datës 18.10.2021 është vendosur: *"*
I.Korrigjohet Aktvendimit të CN.nr.108/2019 i dt.06.10.2021 vetëm sa i përket një gabimi teknik në përshkrim të vlerës tek pika II në pika (c) tek rreshti i dytë ashtu që ku është shënuar; c). E. G nga fshati ..... Komuna e Malishevës për ngastrën .....-.. ZK....., ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 23,643.36 euro,, tani pika II nën pika (c) e dispozitivit të këtij Aktvendimi duhet të jetë c). E. G nga fshati ..... Komuna e Malishevës për ngastrën ....-.. ZK..... , ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 10,983.74 euro.
II.Pjesët tjera të Aktvendimit CN.nr.108/2019 dt.06.10.2021 mbeten të pandryshuar .

Një kopje e këtij Aktvendimi i bashkëngjitet Aktvendimit të Korrigjuar CN.nr.108/2019 dt.06.10.2021"

Kundër këtij Aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesja e kundërpropozueses, Ministria e Drejtësisë –Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit pas administrimit të provave të refuzojë propozimin e propozuesve, në tërësi si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë brenda afatit ligjor ka paraqitur ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i palës propozuese, me propozim që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar në ligj ankesa e përfaqësueses të autorizuar të palës kundërshtare, të vërtetohet në tërësi aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë dhe të detyrohet pala kundërpropozuese që t'ia paguajë palës propozuese në emër të përpilimit të parashtresës/përgjigjes në ankesë, shumën prej 80.00 euro sipas numrit 6 par.1 pika b) të Rregullores për Tarifat e Avokatëve.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e kundër-propozueses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se propozuesit me datë 29.11.2013, kanë paraqitur ankesë kundër vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.09/151, i datës 11.10.2013 pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë.
Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas ankesës së propozuesve ka mbajtur seancë ashtu që pas vlerësimit dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktvendimin, Nd.136/13, i datës 10.11.2016 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e propozuesve dhe e ka detyruar Organin Shpronësues –Qeveria e Republikës së Kosovës që propozuesve t'ua paguajë diferencën e vlerës për ngastrat e shpronësuara sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

2021:265050

Kundër propozuesja e pa kënaqur me aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës e Apelit e Kosovës e cila me aktvendimin, Ac.nr.2917/17, i datës 31.10.2019 e ka aprovuar ankesën e kundërpropozueses duke e kthyer çështjen në rivendosje.
Pas kthimit në rivendosje, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin, CN.nr.328/18, të datës 03.02.2021 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar propozimin e propozuesve, të precizuar me parashtresën e datës 13.07.2020, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se me vendimin përfundimtar numër 09/151 të datës 11.10.2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar shpronësimin e paluajtshmërisë, ngastrave kadastrale .....-..ZK.....me sipërfaqe 890 m2 e cila evidentohet në emër të A.G me ½ dhe Sh.G me ½, dhe .....-..sipërfaqen 2366m2 ZK.....në emër të Sh.G si dhe .....-..me sipërfaqe 624 m2 ZK.....e cila gjatë kohës së shpronësimit ishte në emër të D.B ndërsa tani bazuar në certifikatën e pronës e dorëzuar në ri gjykim kjo nga data 17.06.2015 është në emër të E.G e për të cilat si palë e interesuar e që kanë interes juridik janë propozuesit-ankuesit. Tutje ka shtuar se ky Shpronësimi ka qenë i ligjshëm, është bërë në përputhje me dispozitat e neneve 3,4,7,10, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji numër 03/L139). Organi shpronësues ka vepruar në përputhje me nenin 15 dhe 21 të Ligjit për shpronësim kur ka angazhuar ndërmarrjen konsulentë "I....."me qëllim të vlerësimit të çmimit të tregut të paluajtshmërive ashtu që nga e njëjta është përllogaritur shuma e kompensimit që duhet paguar ankuesit dhe atë vlerën prej 20 euro për m2 në të tri ngastrat e shpronësuara të cekura më lartë, ndërsa nuk është bërë vlerësimi për humbjen vlerës së pronës së mbetur të këtyre ngastrave. Më konkretisht Gjykata e shkallës së parë bazuar në raportin e vlerësimit i bërë gjatë kohës së shpronësimit, ka konstatuar se parcela .....-..në sipërfaqe prej 2366m2 nga Organi i Shpronësimit i kryer nga „I....." është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 me vlerë të përgjithshme 47,320.00 euro, parcela .....-..në sipërfaqen prej 624m2 është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 me vlerë të përgjithshme 12,480.00 euro, kurse parcela .....-..në sipërfaqen prej 890m2 është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 e që si vlerë ka rezultuar 17,800.00 euro. I pakënaqur me këtë vlerësim përkatësisht me çmimin e vlerësuar të kompensimit, ankuesi përmes të autorizuarve të tij ka iniciuar procedurë gjyqësore ku gjatë rrjedhës së saj në tersi e ka kundërshtuar vlerën e kompensimit ashtu që gjatë shqyrtimit të mëparshëm kanë propozuar të bëhet ekspertizë për vlerësimin e paluajtshmërive të shpronësuara.

Gjatë shqyrtimit të parë Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me propozimin e të autorizuarit të ankuesve ka caktuar nxjerrjen e ekspertizës për vlerësimin e pjesëve të shpronësuara të ngastrave kadastrale .....-.., ...-.., ...-.. të gjitha ZK ..... Komuna e Malishevës duke caktuar si ekspert R.B nga ..... vlerësues i pronave të paluajtshme, me të cilin fillimisht Gjykata doli në teren në ngastrat objekt shpronësimi , e që më pas i njëjti ka hartuar raportin e vlerësimit të këtyre paluajtshmërive duke e bërë përshkrimin e pronave të shpronësuara siç është paraqitë në këtë raport dhe pas kësaj ka dhënë vlerësimin e tij mbështetur në parimet e përgjithshme të vlerësimit në përputhje me "manualin e standardëve evropiane të vlerësimit", në standardet e aprovuara nga "komiteti ndërkombëtar i standardeve të lëshimit të aseteve", si dhe nga grupi "evropiani të vlerësuesve TEGOVA". Ka zbatuar praktikat e vlerësimit standard, çertifikatat mbi të drejtën e pronës , kontratat e shitblerjes, ka bërë studim dhe analizë të shitblerjeve të palujtshmërive në një periudhë brenda 5 viteve të kaluara, ka siguruar informata nga agjencitë lokale të palujtshmërive, nga departamenti i tatimit në pronë , nga palët e treta- të besueshme, gjegjësisht nga banorët të asaj zone. E ka zbatuar metodën e shitjeve krahasuese bazuar në udhëzimin administrativ 13/2011 i datës 02.12.2011 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës se kompensimit, për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmet që kanë të bëjnë me shpronësimin. Në këtë mënyrë ka përcaktuar edhe faktorët e vlerësimit që ndikojnë në vlerën e tokës bujqësore, si cilësia, afërsia me vendbanim, qasja me infrastrukturë, madhësi, forma e pronës dhe ujitja. Në bazë të tyre ka dhënë vlerësimin se çmimi

2021:265050

real i pronës me nr..... -... është 36.25 euro për m2 ndërsa për ngastrat .....-.. dhe .....-.. është 35.66 euro për m2. Me këtë vlerësim të ekspertit R.B siç është cekur edhe në vendimin e mëparshëm (ND.nr.136/13) nuk është pajtuar përfaqësuesi i autorizuari i Organit Shpronësues për shkak të dallimit në mes të raportit të vlerësimit tij dhe të "I.....", prandaj i ka propozuar Gjykatës që të nxirret super ekspertizë, propozim ky që nuk u kundërshtua nga të autorizuarit e ankuesve ndërsa Gjykatës i propozuan që grupit të ekspertëve t'i jep detyrë edhe për vlerësimin e zhvleftësimit të pronës së mbetur siç kanë pretenduar në ankesë pasi që eksperti R.B nuk e ka bërë.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e datës 14.12.2015, një propozim të tillë e ka aprovuar dhe ka caktuar grupin e ekspertëve për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe vlerën e humbur të pjesëve të mbetura të pa shpronësuara të ngastrave objekt shpronësimi, ndërsa si ekspert janë caktuar, I.B, A.Ç dhe B.B të cilët gjatë vlerësimit të këtyre paluajtshmërive edhe në rigjykim po e paraqesim të njëjtin përshkrim si në vendimin e mëparshëm (ND.nr.136/13), pra të njëjtit janë bazuar në analizimin e karakteristikave të pronave objekt vlerësimi, vlerave të pronave të ngjashme në pronën objekt vlerësimi duke e aplikuar metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë si dhe raportet nga vlerësimet paraprake të këtyre pronave. Po ashtu kanë përdor metodën e shitjeve krahasues, metodën e të ardhurave dhe të çmimit kushtues , dhe njëkohësisht kanë sqaruar se opinioni i vlerësimit për këto prona është bazuar në faktor që kanë ndikim të drejtpërdrejt në vlerën e tregut si dhe shitblerjet e realizuara viteve të fundit përfshi përshtatjet e nevojshme sipas bazës ligjore. Kanë shtuar se sa i përket përcaktimit të vlerës së tregut të pronave në fjalë në këtë zonë ka vështirësi në gjetjen e dokumenteve zyrtare dhe kontratave të shitblerjes të mjaftueshme dhe të besueshme nga institucionet të realizuara siç kërkohet në udhëzimin administrativ MF-NR.02/2015. Me qëllim të arritjes së një vlere sa më të përafërt të tregut të pasurive të paluajtshme/tokë bujqësore në këtë zonë, janë bazuar në vlerën e tregut të pronave të ngjashme. Trendët e zhvillimit përgjatë autostradës tregojnë se destinimi i tokës bujqësore në vazhdimësi po ndryshojnë duke u shndërruar në tokë ndërtimore. Qasja e drejtpërdrejtë në rrugë, lokacioni shumë të përshtatshëm ndërtimi dhe për banim apo veprimtari biznesore pa përjashtuar edhe cilësitë bujqësore dhe faktor tjerë, vlera e këtyre parcelave ka evoluar në aspektin pozitiv. Kanë marrë për bazë edhe vlerësimet paraprake nga kompania "I....."eksperti vlerësues i çertifikuar i pronave paluajtshme dhe çmimet e tri ofertave aktuale në këtë zonë.

Tutje ka shtuar se grupi i ekspertëve gjatë shqyrtimit të parë ngastrën ....-.. për sipërfaqen e shpronësuar prej 2366m2 e kanë vlerësuar me çmimin prej 39.00 euro për m2 e që si vlerë totale ka rezultuar 92,274.00 euro, ngastrën ....-.. për sipërfaqen prej 624m2, e kanë vlerësuar me çmimin prej 37.89 euro për m2 e që si vlerë totalë ka rezultuar 23,643.36 euro, kurse ngastrën ....-.. për sipërfaqen prej 890m2 e kanë vlerësuar me çmimin prej 39.55 euro për m2 e që si vlerë totalë ka rezultuar 35,199.50 euro. Shuma e përgjithshme për tri ngastrat rezulton të jetë 151,116.86 apo sipas ekspertëve si total është caktuar 150,000.00 euro si shumë totale për sipërfaqet e shpronësuara. Ndërsa sa i përket llogaritjes se vlerës së humbur për pjesë e mbetura-të pa shpronësuara, të njëjtit në raportin e tyre vlerësues të plotësuar kanë theksuar se humbja e vlerës për pjesët e mbetura –të pa shpronësuara të parcelave është parapara me ligjin nr.03/L-139 për Shpronësimin e Palujtshmërive në nenin 18 parg.3. Pjesët e mbetura kanë humbur në vlerë për shkak të humbjes së formë, madhësisë dhe qasjes në rrugën ....-..... dhe anasjelltas. Kur kësaj i shtohet edhe humbja e vlerës edhe për shkak të kufizimeve për ndërtime vlera e humbur është edhe më e madhe. Në ngastrën ....-.. për sipërfaqen e mbetur prej 381 m2 kanë përcaktuar si vlerë të humbur 80 % ashtu që kjo arrin vlerën prej 11,887.20 euro , në ngastrën ....-.., sipërfaqen e mbetur prej 283m2 , vlera e humbur është 80% ashtu që ka vlerën prej 8,578.30 euro ndërsa në ngastrën ....-.. për sipërfaqen prej 3120m2 , vlera e humbur është 50% ashtu që është përcaktuar vlera prej 61,713.60 euro. Këtë vlerësimin të grupit të ekspertëve gjatë seancës së datës 31.10.2016 (gjatë gjykimit të parë) e ka mbrojtur kryesuesi i grupit, eksperti I.B i cili ka dhënë sqarime dhe është përgjigjur pyetjeve të autorizuarve të palëve duke u deklaruar, se i ka

2021:265050

parë tri kontratat të shitjes së lirë në zonë e pronave objekt shqyrtimi, distanca në mes ngastrës së shpronësuar dhe asaj krahasues është 300 deri 400 m, sa i përket pyetjes se cilave kontrata ju ka fal besimi e cilave jo, është përgjigjur se kontratat e shitblerjes të cilat arrijnë shumën deri 10.000 euro nuk janë marrur si reprezentative dhe nuk i kemi marrë për analizat e vlerës , ndërsa për analizë kemi marr vetëm 3 kontratat e shitblerjes të realizuara në ZK..... Gjatë vizitës që i janë bërë pronave kanë bërë fotografimin e tyre dhe kanë parë se ngjit me njërën parcelë është shtëpi e banimit ndërsa prona tjetër ka qenë 20m vetëm një parcelë ka qenë pronë e shtëpisë banimit, që të tri parcelat gjinden për afërsisht 100 deri 150m larg dhe janë në mesë të shtëpive të banimit, ndërsa sa i përket legjislacionit kadastral fletës poseduese këto janë të licencuara si tokë bujqësore mirëpo ky problem qëndron në tërë Kosovën, nuk përputhet realiteti në terren me ngastrat kadastrale. Kontratat nuk janë reprezentative për shkak të një mori çështjesh, e para shumica e kontratave janë kryer në një periudhë të gjatë kohore dhe bartja e tyre nuk është bërë në kohën kur ka ndodhur transaksioni i shitblerjeve reale, kontratat i paraqesim si të tilla për shkak se familjet tona kanë jetuar në një varfëri të madhe dhe me ndarjet familjare nuk i kanë kryer edhe trashëgimin me kohë, arsye tjetër është se ndërrimet e pronave janë bërë ndërrime pronë me pronë por nuk janë vlerësuar me vlera reale, në atë kohë nuk janë bërë bartjet, arsye tjetër është se kontratat e shitblerjes janë bërë me deklarimin vullnetar deri në vitin 2012 në Gjykatë, pas këtij viti te Noteri, dhe ata vetë e caktojnë çmimin e kontratës pa u bërë ndonjë vlerësim real për vlerën e tyre dhe palët i kanë ikur paraqitjes reale të shitblerjes me qëllim që ti shmangen pagesës së taksës në Gjykata apo te noteri dhe taksës administrative. Grupi i ekspertëve si vlerë të përgjithshme për tri ngastrat e shpronësuar .....-.....-..dhe .....-..kanë caktuar vlerën prej 150000 euro ndërsa për pjesët e mbetura të pa shpronësuara të këtyre ngastrave kanë caktuar vlerën prej 84000 euro e që në total rezulton 232,000 euro.

Ndërsa në ri-gjykim e sipas vërejtjeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit (si në Aktvendimin AC.nr.2917/17 datës 31.10.2019) që kanë të bëjnë me precizimin e sipërfaqes së shpronësuar për secilën ngastër kadastrale, sipërfaqen e pronës vlera e së cilës është zvogëluar, precizimit të shumës së gjykuar në emër të diferencës për eksproporim për secilin propozues si dhe shumat e gjykuara për humbjen e vlerës së pronës së mbetur të ngastrave kadastrale për secilin propozues veç e veç, dhe pas precizimit të kërkesë së propozuesve të bërë me datë 13.07.2020 bashkangjitur këtij propozimi edhe certifikatën e pronës së shpronësuar .....-.. si provë, Gjykata e e shkallës së parë ka theksuar se e ka urdhëruar grupin e ekspertëve I.B, A.Ç dhe B.B që të plotësoj ekspertizën përkatësisht raportin vlerësues të datës 08.04.2016 duke u bazuar në këtë provë dhe duke ju referuar vërejtjeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit ashtu që të përcaktojnë saktësisht sipërfaqet e shpronësuar që ju takojnë secilit ankues dhe shumat e diferencës për kompensim për ato pjesë të sipërfaqes së shpronësuar dhe njëkohësisht të caktojnë sipërfaqen e pjesës së mbetur të pronave të shpronësuar të secilit ankues dhe shumat që ju takojnë secilit për pjesën e vlerës së humbur.

Sipas Gjykatës së shkallës së parë kryesuesi i grupit të ekspertëve S.B në plotësimin e raportit të datës 08.10.2020 sipas detyrave të Gjykatës ka përcaktuar sipërfaqet e shpronësuar që ju takojnë secilit ankues dhe shumat e diferencës për kompensim për ato pjesë të sipërfaqes së shpronësuar dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe sipërfaqen e pjesës së mbetur të pronave të shpronësuar të secilit ankues dhe shumat që ju takojnë secilit për pjesën e vlerës së humbur për secilin ankues veç e veç, përkatësisht si në vijim; Sh.G si bashkëpronare e ½ për ngastrën .....-.., sipërfaqen e shpronësuar prej 445m2 , diferencën për kompensim në shumë prej 8571.66 euro, ndërsa sipërfaqja e mbetur pa shpronësuar prej 1.560m2 , shumën për kompensim për humbjen e vlerës së mbetur të kësaj pronë në shumë prej 30,782.96 euro; A.G si bashkëpronare e ½ për ngastrën ....-.., sipërfaqen e shpronësuar prej 445m2 , diferencën për kompensim në shumë prej 8,571.66 euro, ndërsa sipërfaqja e mbetur pa shpronësuar prej 1.560m2, shumën për kompensim për humbjen e vlerës së mbetur të kësaj pronë në shumë prej 30,782.96 euro; Sh.G për ngastrën .....-..sipërfaqen e shpronësuar prej 2366m2, diferencën për kompensim në shumë prej 44.272.69

2021:265050

euro, ndërsa sipërfaqja e mbetur pa shpronësuar prej 381m2, shumë për kompensim për humbjen e vlerës së mbetur të kësaj pronë në shumë prej 11,869.17 euro; E.G për ngastrën ....-.., sipërfaqen e shpronësuar prej 624m2, diferencën për kompensim në shumë prej 10,983.74 euro, ndërsa sipërfaqja e mbetur pa shpronësuar prej 283m2, shumë për kompensim për humbjen e vlerës së mbetur të kësaj pronë në shumë prej 8,564.33 euro.

Eksperti në raport me detalisht ka bërë ndarjet edhe në mënyrë tabelore ndërsa këtë plotësim të raporti e ka mbrojtur edhe gjatë seancë gjyqësore me ç 'rast i është përgjigjur pyetjeve të parashtruar duke dhënë edhe sqarim sidomos për llogaritjen e vlerës së humbur e për më shumë si në procesverbalin e dt.22.10.2020. Nga e gjithë kjo për Gjykatën rezulton se Organi Shpronësues përmes kompanisë "I....." sipërfaqet shpronësuara të ngastrave ....-.., ...-.. dhe ....-.. të përshkruar si deri më tani i ka vlerësuar me nga 20 euro për metër katror , ndërsa eksperti R.B ngastrën me nr..... -.. e ka vlerësuar me 36.25 euro për m2 kurse ngastrat ....-... dhe .....-..me 35.66 euro për m2. Kurse Grupi i ekspertëve I.B, A.Ç dhe B.B ngastrën me nr.....-.. e ka vlerësuar me 39.00 euro për m2 kurse ngastrat ....-... me 37.89 euro për m2 dhe ngastrën ....-... me 39.00 euro për m2. Ky grup i ekspertëve sipas detyrave të Gjykatës ka llogaritur edhe vlerën e humbur të këtyre ngastrave përshkrua si më lart ndërsa kompania "I....."nuk e ka llogarit këtë, po ashtu as eksperti R.B. Ashtu si kompania "I....."edhe eksperti R.B dhe grupi i ekspertëve gjatë vlerësimit të pronave janë Bazuar në ligjin e shpronësimit dhe udhëzimet në fuqi mbi bazën e të cilave edhe kanë hartuar raporte vlerësuese me ç'rast secili raportet i kanë bërë duke u bazuar në Metodën Krahasimore dhe deri te llogaritja e çmimit real janë referuar kritereve dhe faktorëve të vlerësimit pronave duke e kategorizuar me klasa dhe ate Cilësinë, Afërsinë me vendbanimin, Qasjen në infrastrukturë, madhësinë, formën e pronës, Ujitjen, pjerrtësinë në rrugë.

Nga provat e administruar dhe vërtetimi i kësaj gjendje faktike si përfundim për Gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar se ankuesit Sh.G, A. dhe E.G për sipërfaqet e shpronësuar të tri ngastrave lartcekura Organi i Shpronësimit, i ka vlerësuar me nga 20 euro për metër katror dhe për këto janë kompensuar në vlerën e përgjithshme 77600 euro, përkatësisht për ngastrën .....-..në sipërfaqe prej 2366m2 nga Organi i Shpronësimit i kryer nga ,,I....." është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 me vlerë të përgjithshme 47,320.00 euro, ngastrën .....-..në sipërfaqen prej 624m2 është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 me vlerë të përgjithshme 12,480.00 euro, kurse ngastra .....-..në sipërfaqen prej 890m2 është vlerësuar me çmimin prej 20.00 euro për m2 e që si vlerë ka rezultuar 17,800.00 euro. Ndërsa nuk ka bërë vlerësimin e sipërfaqeve të mbetura të këtyre ngastrave nga shpronësimi përkatësisht vlerën e humbur të tyre. Në këtë rast duke bërë krahasimin në mes vlerësimit të organit të shpronësimit i kryer nga ,,I..... " dhe grupit të ekspertëve sa i përket sipërfaqeve të shpronësuar për tri parcelat, konkretisht kemi vlerën totale 77600 euro për tri ngastrat i caktuar nga I..... " dhe 150000 euro i caktuar nga grupi i ekspertëve, dhe dallime apo diferenca e vlerës për kompensimin e sipërfaqeve të shpronësuara rezulton të jetë 72400.01 euro që Organi Shpronësimit duhet të iu kompensoj ankuesve, kurse vlera e përgjithshme për pjesët e mbetura të pa shpronësuar – vlerë e humbur për ngastrat objekt i kësaj lënde është shuma e përgjithshme prej 81999.42 euro që organi shpronësues duhet kompenson ankuesve ashtu që këto dy vlera së bashku arrin shumën e përgjithshme për kompensim prej 154399.40 euro përkatësisht për secilin ankues-propozues veç e veç të përshkruar si në pikën II të dispozititvit të këtij Aktvendimi. Gjykata konstaton se nuk u shqyrtuan prova dhe aktvendimi Cnr.158/13 i datës 18.11.2013 i kësaj gjykate lidhur me caktimin e masës së përkohshme e sigurimit, deklarata e P.V nga.... e datës 13.03.2009, deklarata e J.V, deklarata e H. M nga fshati.....e datës 16.09.2009 pasi që Gjykata vlerësoi se nuk janë relevante dhe të njëjtat orientojnë në drejtim të vërtetimit të pronësisë që është zhvilluar në kontest tjetër dhe në anë tjetër nuk ishin të nevojshme në këtë procedurë pasi që propozuesit Gjykatës i ofruan prova të mjaftueshme me të cilat dëshmuan se të njëjtit janë pronar juridik dhe faktik të pronave të shpronësuar në rastin konkret dhe si Zotëruesi të Interesit të drejtpërdrejt.

2021:265050

Ndërsa provat tjera si; kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me datë 15.11.2011 në mes Ankueses Sh.G dhe M.J, transaksionet bankare të datës 30.03.2009, 08.01.2009 të lëshuar nga "R.....", Kontrata e shitblerjes me nr.LRP.nr ...../....., e lidhur më datë 23.05.2014 në mes të E.G dhe Sh.K në zyrën e noterit I.E në....., raporti i vlerësimit të ekspertit të bujqësisë Ymer Kastrati sipas lëndës 137/13 që nuk është raport vlerësimi për ngastrat e kësaj lënde objekt shpronësimi dhe para kontrata pjesë e këtij vlerësimi e lidhur me datë 04.01.2011 në mes H.G dhe A.S, raporti vlerësues i H.Ll ekspert vlerësues i ngastrës .....-..që nuk është objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se këto ishin pjesë e ekspertizave gjegjësisht të raporteve të vlerësimit të ekspertëve të caktuar nga Gjykata, prandaj Gjykata nuk i shqyrtoi veç e veç pasi që pra ishin pjesë e ekspertizave.

Pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe krahasimit të raportit të kompanisë "I....."ekspertizës - raportit të vlerësimit të ekspertit R.B dhe raportit të vlerësimit të grupit të ekspertëve I.B , A. Ç dhe B.B, njëkohësisht vlerësimit të tyre dhe provave tjera , Gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin e plot raportit të vlerësimit të grupit të këtyre ekspertëve dhe plotësimit të këtij raporti pasi që e njëjta ishte logjike dhe e argumentuar më mirë, raporti i tyre është i mbështetur përveç faktorëve të vlerësimit të paraqitur si më lart e që është i përafërt edhe me raportet e I..... dhe ekspertit R.B, i njëjti raport është i bazuar në tri intervista –ofertat njëkohësisht edhe në vlerësimet e kompanisë I..... dhe ekspertit R.B (në këtë rast me raportin e eksperti R.B është më i përafërt me një dallim të vogël), dhe se grupi i ekspertëve ka hulumtuar më thellësisht për gjetjen e vlerës reale dhe në anën tjetër mendimi prej tre ekspertëve në këtë rast është më determinant dhe më bindës se sa vlerësimet tjera në këtë rast dhe anën në tjetër ky grup ekspertëve ka gjetur se pjesët e mbetur të prova të shpronësuar kanë vlerë të humbur andaj në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe për këto arsye mendimi i këtyre ekspertëve ishte bindëse dhe profesional, ashtu që tek Gjykata është formuar bindja se shuma e gjykuar si në dispozitiv është reale dhe e arsyeshme dhe përgjigjet me çmimin e tregut në atë zonë.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ia ka falur besimin raportit të vlerësimit të Organit Shpronësues i bërë nga I..... pasi që ky raport në krahasim me raportin e grupit të ekspertëve I.B, A.Ç dhe B.B nuk ishte vlerësim real dhe i drejtë, hulumtimi i vlerës së tregut nuk ishte i plot dhe real dhe njëkohësisht nuk ishte vlerësuar vlera e humbur e pjesës së mbetur të pronës së pa shpronësuar. Po ashtu edhe raportit të ekspertit R.B Gjykata nuk ja fali besimin sa i përket llogaritjes së vlerës së tregut pasi që eksperti nuk ka argumentuar bindshme vlerën e dhënë edhe në këtë rast edhe pse është i përafërm me vlerësim e grupit të ekspertëve i njëjti nuk ishte bindës pasi që siç u cek më lart grupi i ekspertëve përveç vlerësimit të tyre kanë marrë për bazë edhe vlerësimet paraprakë përkatësisht të kompanisë I..... dhe eksperti R.B nga ka rezultuar se çmim me real i gjetur nga grupi i ekspertëve është më përafërm me vlerën e tregut në zonën e shpronësuar . Njëkohësisht Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjatë vendim marrjes ka pasur parasysh edhe pretendimet e të autorizuarit të kundër propozuesit mirëpo për Gjykatën pretendimet e tyre ishin të pa bazuar dhe jo real ngase raporti i vlerësimit i Organi i Shpronësimit i bërë përmes ,,I" nuk është vlerësimi real që i përgjigjet çmimit të tregut e që për Gjykatën më i arsyeshëm në këtë rast siç u cek më lart rezultoi të jetë ai që është bërë nga grupi i ekspertëve I.B A.Ç dhe B.B.

Gjykata e shkallës së parë pas analizimit të të gjitha provave të administruara e të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe dëgjimit të kryesuesit të grupeve të ekspertëve për prona të paluajtshme në seancën gjyqësore, erdhi në përfundim se propozimi i parashtruar nga ankuesit-propozuesit dhe i precizuar me datë 09.09.09 e protokolluar në Gjykatë me datë 14.09.2020, për kompensimi shtesë për pronën e shpronësuar dhe për humbjen vlerës së pronës së mbetur për parcelat e lart përmendura, për nga baza juridike është i bazuar dhe i mbështetur në dispozitat ligjore nga neni 15 dhe 16 të ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Palujtshmërive dhe për vlerën e zvogëluar të pronës së mbetur në nenin 18 par.3 dhe 37 të këtij ligji si dhe në Protokolli 1 neni 1 të Konventës

2021:265050

Evropiane për të Drejtat e Njeriut , ndërsa pjesërisht i bazuar për nga lartësia e kompensimit për faktin se kërkesa për kompensimin e diferencës është jashtë vlerave të llogaritura nga grupi i ekspertëve me plotësimin e raportit përkatësisht datës 06.10.2020 e të cilëve Gjykata ja fali besimin. Prandaj edhe e refuzoj pjesën tjetër të kërkesë mbi shumat e gjykuar si në pikën II të dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe llogaritjeve të grupit të eksperteve.

Sa i përket kamatës, Gjykata të njëjtën e aprovoi në vlerë prej 7% ashtu siç është përcaktuar me nenin 16 pika 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe atë nga dita e nxjerrjes së vendimit të fundit përfundimtar të datës 11.10.2013.

Ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës, Gjykata e mori në përputhje me nenin 29 pika 4 të LPJK ndërlidhur me nenin 452 dhe 453 të LPK-së dhe në pajtim me listën e shpenzimeve e cila është hartuar bazuar në tarifën në fuqi të Odës së Avokatëve, udhëzimit për taksa gjyqësore.

Në arsyetim të aktvendimit korrigjues ka theksuar se me datën. 06.10.2021 me Aktvendimin CN.nr.108/2019 për ankesën e ankuesve ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe ky Aktvendim i është dërguar palëve. Mirëpo pas dërgimit të këtij Aktvendimi palëve, Gjykata ka vërejtur se është bërë një gabim teknik në përshkrimin e shumës 23,643.36 euro në piken II nën pika (c) të këtij Aktvendimi tek rreshti i dytë përkatësisht gjatë hartimit të aktvendimit është përshkruar në këtë mënyrë c). E.G nga fshati..... Komuna e Malishevës për ngastrën .....-..ZK....., ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 23,643.36 euro, e që në fakt sipas vlerësimit të Gjykatës e mbështetur në plotësimin e raportit vlerësues të grupit të ekspertëve I.B, A.Ç dhe B.Bdatës 06.10.2020 të cilës edhe ia ka falur besimin , pika II nën pika (c) e dispozitivit të këtij Aktvendimi duhet të jetë c). E.Gnga fshati....., Komuna e Malishevës për ngastrën .....-..ZK....., ti kompensoj diferencën e vlerës në shumën prej 10,983.74 euro.

Gjykata vendosi të bëj korrigjimin e aktvendimit siç u përshkrua në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se është bërë ky gabim teknik gjatë hartimit të këtij Aktvendim siç u përshkrua më lart për çka edhe u deshtë të korrigjohet.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, si dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, po ashtu nuk ekzistojnë as shkeljet e Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme e as të Udhëzimit Administrativ MF-02/2015.

Duke marrë për bazë faktin se pala ankuese në ankesë nuk ka përmend në mënyrë eksplicite ndonjë pikë të caktuar që i referohet shkeljes së dispozitave procedurale, ekzaminimi i Gjykatës së Apelit shkon në drejtim vetëm të shkeljeve për të cilat kjo Gjykatë kujdeset zyrtarisht e në raport me të cilat nuk janë gjetur shkelje.

Pala ankuese me ankesë e ka goditur edhe vërtetimin e gjendjes faktike mirëpo fare nuk e ka elaboruar se ku qëndron pretendimi për shkelje, ndërsa nga ekzaminimi i gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë konstatohet se e njëjta është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë pasi me mendimin e grupit të ekspertëve të cilit mendim Gjykata e shkallës së parë ia ka fal besimin e plotë dhe në atë mendim e ka bazuar vendimin e saj është vlerësuar prona e shpronësuar e propozuesit. Nga të gjeturat e grupit të ekspertëve të cilat i kanë evidentuar në ekspertizë kanë ardhur në përfundim se në bazë të kritereve vlerësuese që janë kriteret mbi pronën, çmimet e lira të tregut kanë ardhur në përfundim se prona e shpronësuar e propozuesve

2021:265050

sipas çmimit të tregut duhet të jetë 39 euro për m2 euro për metër katror si mesatare me çmimet referuese të ofertave të hapura pasi sipas ekspertëve kontratat e vetme që janë gjetur nuk përfaqësojnë çmim real, sepse shitblerja faktike ka ndodhur shumë kohë më parë, pra nuk janë reprezentative, po të njëjtit ekspert për dallim nga eksperti individual dhe organit shpronësues kanë vlerësuar edhe pjesët e pronave të mbetura jashtë shpronësimit në raport me humbjen e vlerës dhe i kanë vlerësuar se njëra pronë më konkretisht prona me numër .....-..në sipërfaqe prej 381 m2 ka humbur vlerën për 80 %, ndërsa prona tjetër .....-..në sipërfaqe prej 3120 m2 ka humbur vlerën prej 50 % si dhe prona .....-..në sipërfaqe prej 283 m2 ka humbur vlerën prej 80 %, duke arsyetuar në mënyrë specifike si humbjen e vlerës faktorët që kanë ndikuar e poashtu edhe diferencën në vlerësim në mes të organit shpronësues dhe mendimit të tyre. Ekspertët kanë arritur të mbrojnë suksesshëm mendimin e tyre edhe në seancë duke dhënë përgjigje në secilën pyetje apo dilemë të shfaqur nga propozuesi apo kundërpropozuesi e madje kanë deklaruar se janë të gatshëm që të përgjigjen në çfarëdo forme për mendimin e tyre dhe mbesin pranë të njëjtit. Ekspertët kanë paraqitur edhe në grafikon qasjen e vështirësuar të propozuesve në pronën e mbetur jashtë shpronësimit si rezultat i shpronësimit, por edhe pronat e marrura si relevancë.

Gjykata me të drejtë ka obliguar kundërpropozuesin që t'ia kompensojë propozuesve në emër të humbjes së vlerës së pronës së mbetur jashtë shpronësimit, sepse propozuesve tani i janë krijuar barriera si rezultat i shpronësimit për të pasur qasje në pronën e tyre dhe kjo ka ndikuar në humbjen e vlerës.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë me referencë në dispozitat e cituara në aktvendimin e atakuar.

Në bazë të Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme nr.03/L-139 të dt.26.03.2009 (dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin nr.03/L-205 të dt.28.10.2010) parashihet se "*Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij Ligji një Organi Shpronësues e nxjer një vendim përfundimtar çdo pronar ose zotërues i interesit në pronën ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi, mund të paraqes ankesë pranë Gjykatës Kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim ose do t'ia pagun atij pronari dhe/ose zotëruesit të intresit*".

Gjithashtu me dispozitën e nenit 37, po të njëjtit ligj, parashihet se kjo rezulton ose me arsye pritet të rezultoi në humbjen e vlerës së pjesës së pa shpronësuar, pronari i pjesës së pa shpronësuar ka të drejtë të paraqes ankesë sipas këtij neni dhe të kërkoi nga Gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi, i cili urdhëron organin shpronësues që të kompensoi humbjen e vlerës, nëse ky kompesim nuk është paraparë me vendimin përfundimtar.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, por të njëjtat nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe.

Ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike jo kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, si për përfaqësime ashtu edhe për taksa gjyqësore dhe ekspertiza e gjithashtu është në harmoni me dispozitat e LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJ-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9731/2021, me datë 16.02.2024

2021:265050

Kryetar i kolegjit - Gjyqtari
***Faton Ademi* d.v**